



**Consolato d'Italia
Scutari**

R I H Y R J E

Kjo lloj vize u lejon hyrjen ne Itali, me qellim vazhdimesine e nje qendrimi kohor te gjate te percaktuar apo te pacaktuar, te huajve mbajtes tashme te lejes se qendrimit, te cilet duke u ndodhur jashte hapesires Shengen, synojne te rihyjne ne Itali dhe gjenden rastesisht te papaisur me lejen e tyre te qendrimit.

Dokumentet qe duhen paraqitur :

- **Pasaporte** (vlefshmeria e pasaportes duhet te jete te pakten prej 7 muajsh)
- **Fotokopje e pasaportes**
- **1 fotografi te formatit per dokument, te njejta dhe te koheve te fundit**
- **Formulari i plotesuar ne cdo pjese te tij** (nje formular per cdo person, perfshi edhe te miturit)
- **Nese leja e qendrimit ka humbur apo eshte vjedhur** : padia prane Autoriteteve te Policise shqiptare e perkthyer ne gjuhen italiane dhe e autentifikuar.
- **Nese lejes se qendrimit i ka mbaruar afati (jo me shume se 60 dite)** : do te jete e nevojshme te paraqitet kuponi ne origjinal i kerkeses se **riperteritjes se lejes se qendrimit** te leshuar nga Kuestura kompetente.
- **Deklarata noteriale**, e perkthyer ne gjuhen italiane, ne te cilen te specifikohet **momenti** dhe **motivi** i kthimit ne Shqiperi, se bashku me vertetimin perkates qe verteton sa eshte deklaruar, e bashkelidhur.
- **Certifikate lindjeje, e perkthyer, e noterizuar dhe e legalizuar nga Ministria e Puneve te Jashtme shqiptare**

VIZA DO TE LESHOHET VETEM PAS MARRJES SE AUTORIZIMIT TE QARTE NGA ANA E KUESTURES KOMPETENTE.

I gjithë dokumentacioni i leshuar nga Autoritetet shqiptare, duhet te jete i perkthyer dhe i legalizuar nga Ministria e Puneve te Jashtme shqiptare.

1. Kujtojme se duke filluar nga data 01/10/2003, kerkuesi i vizes duhet te paguaje koston e saj qe ne momentin e paraqitjes se kerkeses, pavaresisht nga leshimi apo jo i mevonshem i vizes.
2. Zyra rezervon te drejten per te kerkuar paraqitjen e dokumenteve te tjere te mundshem, ne shtese te atyre te treguar me siper, te cilet do te mbahen si te nevojshem, me qellim vleresimin e leshimit te vizes.
3. Te gjithë dokumentet duhet te paraqiten ne origjinale dhe ne fotokopje.
4. Kerkesat e mangeta nga dokumentacioni i mesiper do te refuzohen menjehere ne sportel.